



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*  
*Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry Of*  
*Internal Affairs*

**STRATEGJIA SHITETËRORE KUNDËR  
TERRORIZMIT DHE PLANI I VEPRIMIT  
2018 – 2023**

Shkurt 2018

## **Përmbajtja**

<b>1</b>	<b>Hyrje .....</b>	<b>5</b>
1.1	Qëllimi.....	5
1.2	Vizioni.....	6
<b>2</b>	<b>Metodologjia.....</b>	<b>6</b>
<b>3</b>	<b>Parimet e Përgjithshme .....</b>	<b>7</b>
<b>4</b>	<b>Analiza e situatës aktuale .....</b>	<b>7</b>
<b>5</b>	<b>Korniza ligjore dhe mekanizmat institucional .....</b>	<b>10</b>
5.1	Korniza ligjore .....	10
5.2	Mekanizmi institucional .....	11
<b>6</b>	<b>Objektivat e Strategjisë kundër Terrorizmit .....</b>	<b>15</b>
<b>7</b>	<b>Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i Strategjisë.....</b>	<b>17</b>
7.1	Roli i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit .....	17
7.2	Kapacitetet institucionale për monitorim e vlerësim .....	17
7.3	Indikatorët për monitorim dhe vlerësim .....	18
7.4	Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit .....	18
<b>8</b>	<b>Plani i Veprimit.....</b>	<b>18</b>



## Lista e shkurtesave

AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar
AKF	Agjencia e Kosovës për Forenzikë
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
AKMRRSB	Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore
AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
AME	Agjencia e Menaxhimit Emergjent
ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
DK	Dogana e Kosovës
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
ICITAP	Programi për ndihmë ndërkombëtare në trajnim për hetim të krimit
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MI	Ministria e Infrastrukturës
MIE	Ministria e Integritimit Evropian
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NALT	Ekipi Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës i NATO
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
OPDAD	Zyra Tejoqenaike për Zhvillimin, Asistencën dhe Trajnimin e Prokurorisë
OSBE	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PSH	Prokuroria e Shtetit
QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit
SKSK	Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
SHSK	Shërbimi Sprovues i Kosovës
ZBE	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
ZKM	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave



## Përmbledhje ekzekutive

Strategjia Shtetërore kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018-2023 është dokumenti i tretë strategjik i hartuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të parandalimit dhe luftimit të veprave terroriste.

Terrorizmi vazhdon të mbetet një nga kërcënimet kryesore të sigurisë vendore dhe globale duke kërcënuar jo vetëm jetën dhe pronën, por edhe vlerat demokratike dhe vetë mënyrën e jetesës së shoqërisë. Reagimi efikas ndaj terrorizmit kërkon përfshirjen dhe bashkëpunimin e të gjitha institucioneve publike, shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare, por edhe qytetarëve.

Ky dokument strategjik ka për synim kundërshtimin dhe luftimin e ideologjive ekstremiste apo radikale, të çfarëdo natyre qofshin ato, të cilat mund të shpijnë në përdorimin e dhunës dhe bien ndesh me normat dhe parimet demokratike të shoqërisë kosovare. Tutje, ajo synon në parandalimin e aktiviteteve terroriste, minimizimin e rrezikut nga kërcënimet terroriste, si dhe uljen e cenueshmërisë përmes qasjes gjithëpërfshirëse, jo vetëm ndër institucionale, por gjithë shoqërore, e cila do të krijojë një bazë fleksibile për reagim më efikas ndaj kërcënimeve ekzistuese dhe dinamikave tjera gjithnjë në rritje dhe shumë dimensionale.

Strategjia bazohet në katër shtylla apo objektiva strategjik të cilët janë në harmoni të plotë me Strategjinë e BE-së kundër Terrorizmit:

1. **Parandalimi**, i cili ka për qëllim parandalimin e terrorizmit përmes identifikimit dhe kundërshtimit të shkaktarëve, respektivisht kundërshtimit të ideologjive dhe doktrinave radikale të cilat nxisin individët në akte të dhunës;
2. **Mbrojta**, përmes së cilës do të forcohen kapacitetet mbrojtëse të institucioneve ndaj sulmeve terroriste, respektivisht kërcënimeve të terrorizmit që i paraqiten Republikës së Kosovës ose të interesave të sajë në rajon dhe më gjerë. Përveç forcimit të kapaciteteve mbrojtëse, janë planifikuar edhe masa specifike në minimizimin e cenueshmërisë nga ky fenomen;
3. **Ndjekja**, përmes së cilës agjencitë e zbatimit të ligjit do të ndjekin, hetojnë dhe sjellin para drejtësisë individët apo grupet që paraqesin kërcënim terrorist apo kryerjen e vepra terroriste;
4. **Reagimi**, e cila ka për qëllim përgatitjen e institucioneve në menaxhimin dhe minimizimin e pasojave të një sulmi potencial terrorist. Përgatitja dhe reagimi efektiv janë me rëndësi kritike për të shpëtuar jetën dhe për të minimizuar dëmet dhe pasojat e mundshme.



## 1 Hyrje

Terrorizmi vazhdon të mbetet një nga kërcënimet kryesore të sigurisë, si në nivel vendi po ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, duke kërcënuar jo vetëm jetën dhe pronën, por edhe vlerat demokratike dhe vetë mënyrën e jetesës së shoqërisë. Trendi global i terrorizmit dhe shtrirja e tij, sidomos gjatë dy dekadave të fundit, ka kërcënuar edhe Republikën e Kosovës, si dhe gjithë rajonin, Evropën dhe më gjerë.

Qeveria e Republikës së Kosovës, duke njohur kërcënimet dhe pasojat nga terrorizmi, që në vitin 2009 ka hartuar strategjinë e parë kundër terrorizmit që, përveç se ka krijuar mekanizmat e nevojshëm, ka ofruar edhe një qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit. Prandaj, ky dokument strategjik, i treti me radhë, i hartuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, është vazhdimësi e strategjive të mëparshme dhe ka për qëllim fuqizimin e mëtejshëm të mekanizmave ekzistues, si dhe t'i përshtatet trendëve dhe dinamikave aktuale të kërcënimeve nga terrorizmi.

Parandalimi dhe luftimi i terrorizmit vazhdon të mbetet një ndër prioritetet kryesore strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Strategjia e re kundër Terrorizmit si dhe masat tjera legjislative dhe politike në kuadër të kësaj fushe, janë të ndërlidhura me Prioritetin e dytë Strategjik të Qeverisë për vitin 2017 "Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit." Gjithashtu ndërlidhet me procesin e integrimit evropian dhe si e tillë është pjesë e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2017-2021<sup>1</sup> dhe të konkluzioneve të takimit të parë të nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian të mbajtur me 25-26 janar 2017. Hartimi i kësaj strategjie, e cila është në harmoni të plotë me Strategjinë e BE-së Kundër Terrorizmit, plotëson sfidën e identifikuar nga Komisioni Evropian në Raportin e Vendit për vitin 2016<sup>2</sup>.

Në arritjen e qëllimeve të sipërpërmendura, ky dokument strategjik është i harmonizuar me legjislacionin ekzistues, si dhe dokumentet tjera strategjike të Republikës së Kosovës, por edhe Strategjisë Kundër Terrorizmit të Bashkimit Evropian, i bazuar në katër shtyllat kryesore ekzistuese: a) Parandalimi, b) Mbrojtja, c) Ndjekja dhe d) Reagimi. Për më tepër, Republika e Kosovës, si anëtare e koalicionit global kundër DAESH/ISIS, ka treguar përkushtim dhe njëkohësisht ka marrë përgjegjësi dhe obligime të caktuara, të cilat janë përfshirë në këtë strategji.

Dokumenti përmban objektivat strategjike dhe objektivat tjera specifika për secilën nga shtyllat e sipër përmendura, si dhe do të pasohet me planin e detajuar të veprimit nëpërmjet të cilit do të realizohen objektivat e paraqitura, si dhe do të përcaktojnë mekanizmat zbatues dhe koordinues.

### 1.1 Qëllimi

Orientimi i politikave dhe forcimi i qasjes gjithëpërfshirëse në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit.

---

<sup>1</sup> <http://www.mei-ks.net/repository/docs/pkzmsa20172021shq.pdf>

<sup>2</sup> [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_kosovo.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf)



## 1.2 Vizioni

Ruajtja e ambientit të sigurt në Republikën e Kosovës duke parandaluar dhe luftuar terrorizmin bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese për të gjithë qytetarët.

## 2 Metodologjia

Strategjia Shtetërore kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018-2023, është hartuar në mbështetje të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2017 dhe Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2017-2021.

Strategjia është në harmoni të plotë me Udhëzimi Administrativ nr. 02/2012 për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre si dhe me Rregulloren (QRK) nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik.

Grupi i Punës për hartimin e Strategjisë është formuar nga Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme me Vendimin Nr. 194/2017, të datës 03.07.2017, ku janë të përfshira të gjitha institucionet përkatëse shtetërore, shoqëria civile dhe partnerët ndërkombëtarë. Drafti i strategjisë është hartuar me përfshirjen e të gjithë akterëve të grupit punues ndërsa më qëllim të finalizimit të draftit është mbajtur punëtorja prej 10-13 shtator 2017 të mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ICITAP të cilët gjithashtu kanë mbështetur pjesëmarrjen në punëtori të ekspertit nga Qendra Evropiane për Studime të Sigurisë George C. Marshall.

Strategjia është hartuar duke u bazuar në vlerësimet e brendshme si analizat vjetore të zbatimit të strategjisë së mëparshme për vitet 2012-2017, Vlerësimin të Kërcënimit nga Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar (SOCTA), raportet analitike dhe vlerësuese të Policisë së Kosovës dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, si dhe dokumentet tjera përkatëse. Në anën tjetër, vlerësimet e jashtme përfshijnë raportet e vendit të Departamentit të Shtetit Amerikan, raporteve të EUROPOL-it për situatën e terrorizmit dhe trendit në BE, raportet e Komisionit Evropian si dhe dokumentet tjera.

Me qëllim të përafrimit të politikave dhe legjislacionit vendor në fushën e terrorizmit me ato të Bashkimit Evropian, kjo strategji është harmonizuar me Strategjinë e BE-së kundër Terrorizmit duke i përafruar katër shtyllat përkatëse.

Strategjia bazohet në strategjitë, konceptet dhe qasjen e organizatave dhe iniciativave ndërkombëtare, siç janë: Kombet e Bashkuara, INTERPOL, Bashkimi Evropian, EUROPOL, Koalicioni Global Kundër DAESH/ISIS, Korniza e konsoliduar e OSBE-së për luftën kundër terrorizmit dhe Këshilli i Evropës. Tutje, janë konsultuar gjithashtu edhe strategjitë përkatëse të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Mbretërisë së Bashkuar.



### 3 Parimet e Përgjithshme

Strategjia bazohet në këto parime:

**Parimi i kushtetutshmërisë dhe i ligjshmërisë** - veprimet e ndërmarra për të parandaluar dhe luftuar terrorizmit bazohen në dispozitat e parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionit në fuqi.

**Parimi i qasjes gjithëpërfshirëse shtetërore** - parandalimi dhe luftimi efektiv i kërcënimeve terroristet arrihet përmes qasjes gjithëpërfshirëse ndaj këtij nga të gjitha institucionet qeveritare, publike, shoqërisë civile, sektorit privat dhe organizatave ndërkombëtare.

**Parimi i lirive dhe të drejtave të njeriut** - nënkupton garantimin e lirive dhe të drejtave të gjithë individëve, gjatë të gjitha fazave të angazhimit të institucioneve në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit.

**Parimi i konfidencialitetit** - institucionet me përgjegjësi në parandalimin dhe luftimin terrorizmit duhet të sigurojnë ruajtjen e konfidencialitetit të informatave gjatë procesit të hetimeve proceseve tjera përkatëse.

**Parimi i bashkëpunimit** - Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar e lehtësimit e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve midis institucioneve vendore.

**Parimi i bashkëpunimit ndërkombëtar** - Republika e Kosovës do të luajë rol të rëndësishëm në luftën globale kundër terrorizmit dhe se parandalimi dhe luftimi efikas i terrorizmit arrihet përmes bashkëpunimit ndërkombëtar me shtete, organizata dhe iniciativa, andaj Republika e Kosovës shpreh gatishmërinë dhe përkushtimin e saj që të jetë pjesë e mekanizmave ndërkombëtar që merren me parandalimin dhe luftimin e terrorizmit.

### 4 Analiza e situatës aktuale

Republika e Kosovës, përveç që është sfiduar me forma tjera të ekstremizmit, siç është ai me motive nacionaliste dhe politike, ballafaqohet edhe me ekstremizmin me bazë religjioze. Si pasojë e indoktrinimit nga ideologjitë ekstremiste, qoftë ato nacionaliste apo fetare, një numër i caktuar i shtetasve kosovarë kanë përfunduar në vatrat e konfliktit jashtë vendit, në radhët e organizatave terroriste apo separatiste.

Sa i përket ekstremizmit me bazë nacionaliste, me gjithë përparimet që janë bërë në marrëdhëniet ndëretnike në mes dy komuniteteve më të mëdha në Kosovë, tensionet edhe më tutje vazhdojnë të jenë prezentë dhe të ekzistojnë grupe apo organizata ekstremiste, të cilat janë të predispozuar që kohë pas kohe të përdorin dhunën për arritjen e qëllimeve politike, si dhe të provokojnë incidente ndëretnike, ndonjëherë edhe me mbështetjen e vendeve të treta.



Ndër kërcënimet kryesore vazhdon të mbetet ekstremizmi me bazë fetare, si rezultat i indoktrinimit me ideologji ekstremiste islamiste të importuara në Kosovë nga vendet e Lindjes së Mesme. Pasojat nga këto ideologji tashmë janë evidente, duke filluar nga: bashkëngjitja e qindra shtetasve kosovarë në zonat e konfliktit në radhët e organizatave ekstremiste/terroriste, dhjetëra personave tashmë të vrarë, familje që vazhdojnë të mbesin në zonat e konfliktit, tendencë për përhapjen e ideologjive ekstremiste të dhunshme, krijimin e diskursit të mos tolerancës, si dhe ajo që është më shqetësuese rritjen e kërcënimeve të sulmeve terroriste.

Ekstremizmi islamik në rajon, ka filluar të përhapet në vitet e 90-të, ndërsa në Kosovë, përhapja e tij ka filluar që nga koha e pas luftës, përmes disa organizatave joqeveritare, të cilat krahas programeve sociale dhe humanitare, duke përfutur nga cenueshmëria e një pjese të popullatës në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, kanë përhapur edhe doktrinën dhe ideologjitë ekstremiste islame, të bazuara në jo tolerancë, ndarje, urrejtje, si dhe kundërshtim të sistemit dhe vlerave demokratike përmes promovimit të islamit politik. Rol në përhapjen e ekstremizmit islamik kanë pasur edhe individ të caktuar, të cilët kanë përfunduar studime në vende të ndryshme të Lindjes së Mesme. Po ashtu, propaganda përmes internetit është shfrytëzuar në masë të madhe nga ekstremistët për përhapjen e ideologjive të tyre.

Pavarësisht kundërshtimit të vazhdueshëm dhe rezistencës ndaj këtyre ideologjive, pjesë të caktuara të shoqërisë që ishin më të cenueshme, të gjendur të ekspozuar ndaj këtyre ideologjive, kanë rënë viktimë e tyre duke vazhduar thellimin në ekstremizëm dhe radikalizëm. Më tutje trendët globale në aspektin e ekstremizmit, si dhe fillimi i konflikteve në Lindje të Mesme, veçanërisht në Siri dhe Irak, ku u konsoliduan grupet dhe organizatat terroriste, është shfrytëzuar si moment për shpërfaqjen e ekstremizmave dhe këto konflikte u shndërruan në një fushë graviteti për luftëtarët e huaj terroristë nga gjitha Evropa dhe më gjerë, duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës.

Si rezultat i bashkëngjitjes së këtyre shtetasve kosovarë në organizata terroriste janë shënuar edhe thirrje publike nga ana e tyre për sulme terroriste në Kosovë dhe rajon, por edhe janë shënuar tentativa për kryerjen e akteve terroriste të parandaluara nga institucionet e sigurisë në Kosovë. Me gjithë faktin që organizatat terroriste janë duke humbur territor dhe kontroll në vatrat e krizës, në aspektin ideologjik ato vazhdojnë të kenë mbështetje dhe të shtrijnë ndikimin në vende tjera, duke përfshirë edhe rajonin.

Rreziku me të cilin përballet Kosova janë personat e kthyer nga zona e konfliktit, si dhe personat e përfshirë në vepra penale të terrorizmit, me një interes për ta dëmtuar Kosovën si një shtet me shoqëri me diversitet etnik dhe fetar dhe me një qeveri demokratike dhe shoqëri laike. Siç është parë nga shembuj të shumtë në Evropë, individët e radikalizuar mund të kryejnë akte të dhunës ekstreme edhe ndaj popullsisë dhe institucioneve edhe në shtetin e tyre, prandaj edhe rreziku që Kosova do të mund të jetë në shënjestër për një sulm të tillë terrorist nuk mund të përjashtohet.

Ndër kërcënimet e mundshme me të cilat mund të ballafaqohet Republika e Kosovës janë:

- **Sulmet terroriste-** qoftë nga pjesëtarët e organizatave terroriste përmes luftëtarëve të huaj terroristë, celulave të fjetura por edhe nga simpatizantët dhe mbështetësit që mund të inspirohen për kryerjen e akteve të dhunshme.





- **Indoktrinimi me ideologji ekstremiste**-e bazuar kryesisht përmes propagandës, indoktrinojnë dhe rekrutojnë personat e rinjë për t'i përdorur për qëllime të organizatave terroriste;
- **Migrimi i parregullt** - duke marrë parasysh pozitën gjeografike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përveç kthimit të luftëtarëve të huaj me origjinë nga këto vende, shqetësim tjetër ngelet edhe mundësia që edhe luftëtarët e huaj terroristë nga vendet tjera të shfrytëzojnë vendet e Ballkanit Perëndimor, duke u përzier edhe me refugjatët e mundshëm, me synim që pastaj të udhëtojnë drejt vendeve të BE-së.

Institucionet e Republikës së Kosovës, me kohë kanë identifikuar kërcënimet dhe kanë ngritur shqetësime për pasojat e mundshme nga përhapja e ideologjive ekstremiste dhe radikalizmit në Republikën e Kosovës. Bazuar në këto shqetësime dhe kërcënimet e identifikuara, institucionet e Republikës së Kosovës, ndër të parat në rajon kanë ndërmarrë veprime dhe aktivitetet konkrete në përballje me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin, kryesisht të fokusuara në tri aspekte:

- **Parandalimit të përhapjes së ideologjive ekstremiste dhe radikalizmit** - Institucionet e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim dhe në koordinim shumë të ngushtë edhe me shoqërinë civile dhe komunitetin fetar, kanë hartuar Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm, e cila është e fokusuar në fushën e parandalimit, minimizimin e faktorëve shtytës që mund të ndikojnë në radikalizëm, deradikalizimin e personave të radikalizuar, si dhe riintegrimi i tyre në shoqëri.
- **Harmonizimi dhe avancimi i infrastrukturës ligjore dhe dokumenteve strategjike** - ndryshim-plotësimi i legjislacionit primar, duke përfshirë miratimin e Ligjit për ndalimin e bashkimit të qytetarëve të Kosovës në konflikte jashtë territorit të vendit. Përveç aspektit legjislativ, Qeveria ka miratuar një varg dokumentesh strategjike me qëllim të përballjes me të gjitha sfidat dhe kërcënimet ndaj Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe çështjet që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi kanë të bëjnë edhe me terrorizmin.
- **Ndjekja dhe procedimi penal**- Që nga viti 2013, institucionet e sigurisë dhe ato të drejtësisë së Republikës së Kosovës kanë ndërmarrë veprime konkrete në ndjekjen, arrestimin, dhe procedimin penal të të gjithë personave për të cilët ekziston dyshimi i bazuar që kanë kryer apo janë në përgatitje e sipër për kryerjen e veprave penale të terrorizmit dhe atyre që ndërldihen me terrorizmin.



## 5 Korniza ligjore dhe mekanizmat institucional

### 5.1 Korniza ligjore

Në fushën e terrorizmit, Republika e Kosovës ka në zbatim një bazë të gjerë ligjore, e cila përfshin por nuk kufizohet në:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës<sup>3</sup>;
- Ligji Nr.05/L-002 për Ndalimin e Bashkimit në Konflikte të Armatosura Jashtë Territorit të Vendit<sup>4</sup>;
- Ligj për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit;<sup>5</sup>
- Ligji nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës<sup>6</sup>;
- Ligji nr.03/L -166 për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik<sup>7</sup>;
- Ligji nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike<sup>8</sup>;
- Ligji nr.05/L-030 për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike<sup>9</sup>;
- Ligji nr.03/L - 172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<sup>10</sup>;
- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë<sup>11</sup>;
- Ligji nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë Publike<sup>12</sup>;
- Ligji nr. 03/L063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë<sup>13</sup>;
- Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale<sup>14</sup>;
- Ligji nr. 03/ L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare<sup>15</sup>;
- Ligji nr. 04/L-213 për Ndihmën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale<sup>16</sup>;
- Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare<sup>17</sup>;
- Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror<sup>18</sup>;
- Ligji nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë<sup>19</sup>;
- Ligji nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike<sup>20</sup>;
- Ligji nr.04/L -004 për Shërbimet Private të Sigurisë<sup>21</sup>;
- Ligji nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës<sup>22</sup>;
- Kodi nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizës i Kosovës<sup>23</sup>;
- Ligji nr. 04/L-099 për Ndryshim-Plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë, nr. 03/L-109<sup>24</sup>;

---

<sup>3</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

<sup>4</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10763>

<sup>5</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540>

<sup>6</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2521>

<sup>7</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2682>

<sup>8</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2851>

<sup>9</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10968>

<sup>10</sup> <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2676>

<sup>11</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>

<sup>12</sup> <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2651>

<sup>13</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2538>

<sup>14</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>

<sup>15</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2674>

<sup>16</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8871>

<sup>17</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2789>

<sup>18</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2801>

<sup>19</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2781>

<sup>20</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8860>

<sup>21</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2741>

<sup>22</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2523>

<sup>23</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2600>

<sup>24</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2823>



- Ligji nr.03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë<sup>25</sup>;
- Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës<sup>26</sup>;
- Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale<sup>27</sup>;
- Ligji nr.03/L-122 për Shërbim të Jashtëm të Republikës së Kosovës<sup>28</sup>;
- Ligji nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës<sup>29</sup>
- Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat<sup>30</sup>;
- Ligji nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit<sup>31</sup>;
- Ligji nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës<sup>32</sup>;
- Ligji nr.03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës<sup>33</sup>;
- Ligji nr.04/L-015 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve<sup>34</sup>;
- Ligji nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar<sup>35</sup>;
- Ligji nr. 04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfituar me Vepër Penale<sup>36</sup>;
- Ligji nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale<sup>37</sup>;
- Kodi nr .03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur<sup>38</sup>;
- Rregullore nr.18/2011 për Shpërndarjen dhe Transferimin e Informacionit të Klasifikuar<sup>39</sup>
- Ligji nr. 05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit<sup>40</sup>.
- Ligji nr. 05/L-022 për Armë<sup>41</sup>.

## 5.2 Mekanizmi institucional

Mekanizmi institucional nënkupton të gjithë mekanizmat të cilët kanë rol dhe rëndësi në luftën kundër terrorizmit në Kosovë.

Kompetencat e secilit institucion relevant të përfshirë në hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në fushën kundër terrorizmit janë por nuk kufizohen në institucione:

### Ministria e Punëve të Brendshme

MPB është institucioni përgjegjës qeveritar që udhëheq në hartimin dhe monitorimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e sigurisë së përgjithshme dhe terrorizmit. Përmes mekanizma dhe agjencive të saja, MPB ndërmerr aktivitetet në parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin ndaj të gjitha aktiviteteve terroriste.

---

<sup>25</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2690>

<sup>26</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834>

<sup>27</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

<sup>28</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2615>

<sup>29</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2713>

<sup>30</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2700>

<sup>31</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2710>

<sup>32</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2709>

<sup>33</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2526>

<sup>34</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2758>

<sup>35</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12360>

<sup>36</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8651>

<sup>37</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8871>

<sup>38</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2698>

<sup>39</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10554>

<sup>40</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10936>

<sup>41</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11018>



### **Koordinatori Nacional kundër Terrorizmit**

Koordinatori Nacional kundër Terrorizmit është Ministri i Punëve të Brendshme, ose personi i autorizuar nga ai, i cili është përgjegjës të bashkërendojë, udhëzojë, monitorojë dhe të raportojë për zbatimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve në lidhje me Strategjinë kundër Terrorizmit.

### **Sekretariati i Strategjive**

Sekretariati i Strategjive në MPB ka për detyrë të monitorojë në baza të rregullta zbatimin e strategjisë duke mbledhur dhe analizuar të dhëna rreth zbatimit të aktiviteteve të planit të veprimit, si dhe duke hartuar raportet periodike dhe vlerësuese për Koordinatorin Nacional. Përveç këtyre, Sekretariati do të ndihmojë Koordinatorin Nacional për koordinim e strategjisë dhe komunikimin me palët e interesit.

### **Policia e Kosovës**

Si agjenci e zbatimit e ligjit në kuadër të MPB-së, PK ka përgjegjësinë kryesore në luftimin e terrorizmit, përmes Drejtorisë kundër Terrorizmit dhe strukturave tjera mbështetëse në kuadër të Policisë së Kosovës.

### **Agjencia e Kosovës për Forenzikë**

Si agjencia për zbatimin e ligjit në kuadër të MPB-së, AKF ka përgjegjësi në kryerjen e ekspertizave forenzike profesionale dhe sipas standardeve ndërkombëtare si dhe në menaxhimin databazave forenzike.

### **Agjencia e Menaxhimit Emergjent**

Si agjenci në kuadër të MPB-së, AME ka përgjegjësi në zhvillimin e të gjitha masave për t'u përgatitur, mbrojtur, reaguat dhe rimëkëmbur nga të gjitha rreziqet e mundshme, qofshin ato natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri.

### **Agjencia e Kosovës për Inteligjencë**

AKI bën identifikimin e kërcënimeve që rrezikojnë sigurinë e Kosovës, integritetin territorial, integritetin e institucioneve, rendit kushtetues, stabilitetin dhe zhvillimit ekonomik, si dhe kërcënimet ndaj sigurisë globale në dëm të Kosovës, duke përfshi nxitjen, ndihmën ose shtytjen dhe përkrahjen e terrorizmit. AKI është agjenci për siguri dhe inteligjencë e cila mbledh, analizon dhe shpërndan produkte inteligjente në mënyrë të shpejtë, të ligjshme dhe të përgjegjshme tek Presidenti, Kryeministri dhe Institucionet tjera kompetente.

### **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

KGJK zhvillon politika efektive për sistemin gjyqësor për trajtim më efikas të rasteve të terrorizmit dhe dënimin e personave të përfshirë në aktivitete terroriste. KGJK siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor në vendimmarrje.

### **Sistemi Gjyqësor**

Rastet e terrorizmit në Kosovë trajtohen nga në tri nivele: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Supreme, kurse gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve janë të pavarur, të paanshëm, pa ndikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik përfshirë edhe organet publike.



### **Këshilli Prokurorial i Kosovës**

Këshilli zhvillon politika efektive për sistemin prokurorial për hetimin dhe përndjekjen më efektive të personave të përfshirë në aktivitete terroriste. KPK-ja siguron një sistem prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm.

### **Prokuroria e Shtetit**

Është institucion i pavarur, me autoritet dhe me përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të dyshuar dhe akuzuar për përfshirjen e tyre në aktivitete terroriste PSRK ka kompetencë të veçantë që të hetojë dhe të ndjekë veprat penale të natyrës së veçantë, përfshirë edhe kryerjen, përgatitjen, bashkëpunimin dhe lehtësimin e kryerjen së veprave penale të terrorizmit.

### **Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës**

Sekretariati, si pjesë përbërëse e Këshillit të Sigurisë së Kosovës bën përgatitjen e raporteve periodike dhe analizave për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Këshillin e Sigurisë së Kosovës që kanë të bëjnë me çështjet politike të sigurisë. Duke pasur parasysh rrezikun që aktivitetet terroriste paraqesin për sigurinë e Kosovës, ky sekretariat është po ashtu i përfshirë në koordinimin e hartimit të strategjisë nacionale të sigurisë dhe politikave të sigurisë në Kosovë, përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve, instrumentet e politikave dhe hulumtimit.

### **Ministria e Drejtësisë**

MD përgatitë dhe zhvillon legjislacionin në fushën e drejtësisë, si dhe koordinon dhe zhvillon bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale. Gjithashtu, bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me të gjitha ministritë, agjencitë dhe komunitetet fetare të cilat në forma të ndryshme ndërlidhen me procesin e deradikalizimit dhe risocializimit të të dënuarve për terrorizëm

### **Shërbimi Korrektues**

Shërbimi Korrektues i Kosovës, në bashkëpunim me të gjithë partnerët e drejtësisë, synon të korrektojë dhe të risocializojë personat e dënuar për aktivitete kriminale me theks të veçantë në parandalimin e radikalizimit në burgje duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën dhe religjionin, si dhe siguron një ambient të sigurt për stafin, të burgosurit dhe shoqërinë.

### **Shërbimi Sprovues i Kosovës**

SHSK është përgjegjës për Ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative, mbikëqyrjen, risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin e të gjithë personave që kanë kryer vepra penale të ndëshkueshme sipas ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Po ashtu, SHSK ka për mandat edhe riintegrimin dhe rehabilitimin e personave të liruar me kusht nga burgju.

### **Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës**

MFSK përmes mekanizmave të saj ndihmon institucionet vendore në parandalimin e terrorizmit, ndërsa me njësitet e saja merr pjesë aktive në mbrojtje dhe reagim ndaj sulmeve të mundshëm terroriste.



### **Ministria e Financave**

MF do të ketë rol aktiv dhe bashkëpunues me të gjitha institucionet e ndikuar nga Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë kundër Terrorizmat, duke u përkujdesur që aktivitetet dhe objektivat e parapara të realizohen brenda ndarjeve të rregullta buxhetore.

### **Dogana e Kosovës**

Si agjenci në kuadër të Ministrisë së Financave, DK duke ushtruar funksionin e vet të kontrollit të mallrave dhe personave në pikat e kalimit kufitar dhe brenda territorit të Kosovës kontribuojnë në parandalimin, identifikimin, raportimin, hetimin dhe bllokimin e burimeve të financimit të aktiviteteve terroriste.

### **Njësia e Inteligjencës Financiare**

Si agjenci në kuadër të Ministrisë së Financave, NJIF është përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit.

### **Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

ARKEP është organi rregullator, i cili zbaton dhe mbikëqyrë kornizën rregullatore të përcaktuar nga ligji për Komunikime Elektronike, nga ligji për shërbimet postare, si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

### **Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

MASHT luan rëndësishëm në fushën e parandalimit dhe vetëdijesimit nëpërmjet hartimit të kurrikulave, organizimit të aktiviteteve vetëdijesuese në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

### **Ministria e Punëve të Jashtme**

Ministria e Punëve të Jashtme luan rol të rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit, duke pasur për mision (përveç tjerave) formulimin dhe zbatimin e politikës së jashtme, zhvillimin dhe bashkërendimin e politikave në raport me vendet tjera si dhe përgjegjësi të rëndësishme të koordinimit të dikastereve qeveritare dhe shtetërore që kanë të bëjnë me çështjet e marrëdhënieve ndërkombëtare.

### **Ministria e Integritimit Evropian**

MIE siguron që korniza ligjore dhe politikat qeveritare, të lidhura me parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, janë në harmoni me legjislacionin dhe politikat e BE-së.

### **Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

Krijon politikën kulturore, rinore, sportive dhe të trashëgimisë, harton programe për shqyrtimin e nevojave të të rinjve dhe përkrahjen e tyre dhe në veçanti identifikimin dhe përkrahjen e grupeve specifike të rrezikuara. Krijon programe për ngritjen e nivelit të komunikimit kulturor dhe bashkëjetesës mes kulturave të të gjitha komuniteteve etnike, fetare apo gjuhësore në vend, duke përfshirë edhe promovimin kulturor dhe bashkëpunimin në fushën e kulturë, rinisë dhe sportit.



### **Agjencia e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore**

Si organ i pavarur në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, AKMRRSB është agjenci e specializuar për zbatimin e politikave dhe standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.

### **Zyra për mbrojtjen dhe ndihmë të viktimave**

Zyra për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave (ZMNV) është zyre e pavarur që funksionin në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. ZMNV është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për viktimat gjatë procedurave ligjore, informimin për të drejtat e tyre si dhe përfaqësimin e interesave të tyre në sistemin penal të Kosovës. Zyra po ashtu asiston viktimat në plotësimin e kërkesave për kompensim në procedurat kriminale dhe aplikimin e kompensimeve shtetërore.

## **6 Objektivat e Strategjisë kundër Terrorizmit**

Kërcënimet nga terrorizmi janë të vazhdueshme, andaj edhe parandalimi dhe luftimi i tij kërkon përkushtim dhe angazhim të vazhdueshëm, si dhe zhvillim të mëtejshëm të kapaciteteve. Prandaj, përkundër faktit se Institucionet e Republikës së Kosovës kanë arritur rezultate të kënaqshme në fuqizimin e kapaciteteve, si dhe efikasitet në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, megjithatë konteksti aktual në Kosovë, si dhe trendi i zhvillimeve globale, nga të cilat mund të ndikohet edhe Republika e Kosovës, ngrit nevojën e domosdoshme për këtë dokument strategjik, me qëllim të parandalimit dhe luftimit efikas të terrorizmit.

Duke u bazuar në efikasitetin dhe rezultatet nga strategjitë paraprake, edhe më tutje, aktivitetet e Institucioneve të Republikës së Kosovës në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit janë të orientuara në katër shtyllat kryesore: **PARANDALIMI, MBROJTJA, NDJEKJA DHE REAGIMI**, të cilat janë vendosur si objektiva strategjike:

### **1. PARANDALIMI**

**Parandalimi** si objektivë e veçantë ka një rol thelbësor në luftimin e terrorizmit, në identifikimin dhe kundërshtimin e shkaktarëve, respektivisht kundërshtimin e ideologjive dhe doktrinave radikale të cilat nxisin individët në akte të dhunës. Përveç angazhimit të organeve të sigurisë dhe zbatimit të ligjit, infrastrukturës adekuate ligjore, kjo kërkon edhe një mobilizim më të gjerë të spektrit shoqëror për të pasur një rezultat efikas në minimizimin apo eliminimin e shkaktarëve të radikalizmit dhe ekstremizmit që shpien në terrorizëm.

Për efekt të kësaj strategjie, e cila është gjithëpërfshirëse në luftimin e Terrorizmit, janë paraqitur edhe prioritetet kyçe të parandalimit që përfshijnë po nuk kufizohen vetëm në to janë:

- Kundërshtimi dhe luftimi i ideologjive apo doktrinave radikale dhe ekstremiste dhe atyre që e promovojnë atë;
- Parandalimi i individëve potencial që mund të tërhiqen nga doktrinën apo ideologjitë ekstremiste për t'u shndërruar në ekstremist të dhunshëm dhe terrorist.

Lidhur me luftimin e ideologjive dhe doktrinave radikale dhe ekstremiste, që fokusin kryesor e ka në parandalim Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar strategjinë për parandalimin e



ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015 - 2020 pasuar me një plan të veprimit të detajuar që kryesisht fokusohet në parandalim. Prandaj, strategjia e lartcekur e trajton në detaje aspektin e luftimit të ideologjive dhe doktrinave, bazën e shkaktarëve, faktorët shtytës dhe tërheqës, si dhe aspekte tjera që lidhen në këtë shtyllë.

Për efekt të kësaj strategjie, e cila është gjithëpërfshirëse në luftimin e Terrorizmit, janë paraqitur edhe prioritetet kyçe të parandalimit që përfshijnë po nuk kufizohen vetëm në to janë:

- Kundërshtimi dhe luftimi i ideologjive apo doktrinave radikale dhe ekstremiste dhe atyre që e promovojnë atë;
- Parandalimi i individëve potencial që mund të tërhiqen nga doktrinat apo ideologjitë ekstremiste për t'u shndërruar në ekstremistë të dhunshëm dhe terroristë.

## 2. MBROJTJA

Ky objektivi nënkupton forcimin e kapaciteteve mbrojtëse nga sulmet terroriste, respektivisht kërcënimi i terrorizmit që i paraqitet Republikës së Kosovës ose të interesave të saj në rajon dhe më gjerë. Përveç forcimit të kapaciteteve mbrojtëse, kjo nënkupton edhe minimizimin e cenushmërisë nga ky fenomen. Viteve të fundit në vendin tonë ka pasur rritje të këtyre kapaciteteve, me theks të veçantë në ato të zbatimit të ligjit, të cilat kanë luajtur rol kyç në vlerësimin dhe minimizimin e rrezikut të paraqitur nga terrorizmi.

Objektivat specifike të mbrojtjes në vitet 2018-2023 do të përfshijnë:

- Forcimi i kontrollit në pikat kufitare dhe vijën e gjelbër të kufirit;
- Mbrojtja e pronës dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës që mund të jenë shënjestër e sulmeve terroriste;
- Mbrojtja e ngarkesave dhe materialeve me rrezikshmëri të lartë.

## 3. NDJEKJA

**Ndjekja** - synimi i këtij objektivi është ndjekja, hetimi dhe sjellja para drejtësisë e individëve apo grupeve që paraqesin kërcënim terrorist apo kryerjen e veprave terroriste.

Për arritjen e këtij objektivi, gjatë viteve 2018 - 2023, do të ndërmerren këto masa, por nuk do të kufizohen vetëm në:

- Pengimi dhe hetimi i ekstremistëve të dhunshëm apo terroristëve që ndikojnë, rekrutojnë, financojnë, mbështesin, planifikojnë dhe tentojnë të ndërtojnë legjitimitet brenda territorit të Republikës së Kosovës;
- Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve për ndjekje dhe procedim efikas;
- Rishikimi dhe plotësimi i kornizës ligjore;
- Ngritja dhe zgjerimi i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar.

## 4. REAGIMI

Përgatitja e Institucioneve të Kosovës për të menaxhuar dhe minimizuar pasojat e një sulmi terrorist, duke përmirësuar aftësitë për t'u marrë me pasojat, koordinimin e reagimit dhe menaxhimin e





viktimave. Përveç përpjekjeve maksimale për të parandaluar veprimet terroriste, do të bëhen përpjekje të vazhdueshme për të reaguar në mënyrë më efikase dhe efektive për të parandaluar kryerjen e çfarëdo akti terrorizmi dhe për t'iu përgjigjur sulmeve. Përgatitja dhe reagimi efektiv janë me rëndësi kritike për të shpëtuar jetën dhe për të minimizuar dëmet dhe pasojat e mundshme.

Në arritjen e këtij synimi, gjatë viteve 2017 - 2023, do të ndërmerren këto masa, por nuk do të kufizohen vetëm në:

- Gatishmëria për reagim dhe menaxhim të situatave me qëllim të minimizimit të pasojave në rast të ndonjë sulmi të mundshëm terrorist;
- Fuqizimi i kapaciteteve dhe aftësisë reaguese të institucioneve përkatëse për përgatitje dhe reagim;
- Ofrimi i mbrojtjes, mbështetjes dhe ndihmës për viktimat nga aktet terrorizmit, duke përfshirë përgjigjet emergjente, por gjithashtu qasje në shërbimet e tjera në dispozicion përfshirë edhe të drejtën për kompensim dhe dëmshpërblim.

## **7 Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i Strategjisë**

### **7.1 Roli i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit**

Procesi i implementimit të Strategjisë do të synojë përmbushjen e objektivave strategjike, atyre specifike dhe aktiviteteve. Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve do të jetë pjesë përbërëse e procesit të strategjisë, si dhe elemente kyçe në përmbushjen e saj.

Përmes monitorimit do të bëhet mbledhja e vazhdueshme dhe sistematike e të dhënave për matjen e progresit dhe zbatueshmërisë së Planit të Veprimit. Vlerësimi do të bëhet në baza të rregullta periodike, çdo 1 vit, por edhe ad-hoc, përmes së cilës do të vlerësohet zbatueshmëria e Planit të Veprimit dhe ndikimit apo impaktit në praktikë. Procesi i vlerësimit do të rezultojë në rishikimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit duke siguruar planifikimin e aktiviteteve të nevojshme për zbatimin efektiv të objektivave strategjike dhe harmonizimin me trendët e kërcënimeve vendore dhe globale.

Dimensionet kryesore të monitorimit dhe të vlerësimit të Planit të Veprimit të Strategjisë janë:

- Kapaciteti institucional;
- Indikatorët e monitorimit përgjatë dhe në fund të periudhës tre vjeçare;
- Burimet e informimit dhe instrumentet e matjes.

### **7.2 Kapacitetet institucionale për monitorim e vlerësim**

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit do të zgjerohet për të mbuluar të gjitha institucionet përgjegjëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Strategji dhe në Plan të Veprimit:

- Koordinatori Nacional kundër Terrorizmit, si institucion udhëheqës për koordinimin e përmbushjes së objektivave, do të monitorojë indikatorët e Strategjisë kundër Terrorizmit;
- Sekretariati i Strategjive, do të monitorojë në baza të rregullta zbatimin e Planit të Veprimit duke mbledhur raportet tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore, vjetore dhe ad - hoc nga



të gjitha institucionet përkatëse, dhe do të hartojë raporte analitike të zbatimit të strategjisë sipas nevojës;

- Ministritë, organet zbatuese të ligjit dhe institucionet e tjera të shënuara në Plan të Veprimit do të jenë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve që u janë ndarë atyre ministrive apo institucioneve vartëse të tyre. Këto institucione do të dorëzojnë raportet e tyre tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore tek Sekretariati i Strategjive;
- Organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare do të marrin pjesë në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë duke forcuar gjithëpërfshirjen, transparencën dhe llogaridhënien.

### **7.3 Indikatorët për monitorim dhe vlerësim**

Secili aktivitet në kuadër të Planit të Veprimit ka indikatorët përkatës kualitativ dhe kuantitativ që do të shërbejnë gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit.

### **7.4 Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit**

- Të dhëna administrative/statistikore nga akterët e ndryshëm përkatës;
- Raporti vjetor i zbatimit të Strategjisë dhe raportet tjera ad-hoc;
- Raportet e jashtme nga organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare;
- Anketat e ndryshme.

## **8 Plani i Veprimit**

Plani i Veprimit reflekton përputhshmërinë e tij me kornizën e përgjithshme të Strategjisë kundër Terrorizmit.

Plani i Veprimit do të rishikohet në fund të çdo viti në mënyrë që të sigurohet zbatueshmëria e Strategjisë dhe harmonizimi me trendët vendore dhe ndërkombëtare.

Plani i Veprimit për implementimin e kësaj Strategjie përfshin:

- Objektivat strategjike;
- Objektivat specifike;
- Aktivitetet konkrete për implementim;
- Përcaktimin e institucioneve përgjegjëse dhe përkrahëse për përmbushjen e secilit objektiv;
- Specifikimin e kornizës kohore për përmbushjen e secilit aktivitet;
- Përcaktimin e burimeve të nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve;
- Përcaktimin e indikatorëve për implementimin e secilit objektiv dhe aktivitet.

Plani i Veprimit është dokument i brendshëm dhe me shpërndarje të kufizuar.